



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

KËSHILLI I BASENIT UJËMBLEDHËS SEMAN



VENDIM

Nr.08, datë 01.12.2020

PËR

MIRATIMIN E LEJES, PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR TË LUMIT TË BECIT, PËRRENJVE TË OPARIT, DY BURIMEVE, ÇIFUTIT DHE PËRROIT ARA E PIRGUT, DEGË E LUMIT DEVOLL PËR HEC MAZREKA, BASHKIA KORÇË, QARKU KORÇË PËR PRODHIM HIDROENERGJIE

Në mbështetje të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.111/2012, i ndryshuar me ligjin 6/2018, datë 8.2.2018, për "Menaxhimin e integruar të burimeve ujore" VKM nr. 221, datë 26.4.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore", si dhe të VKM Nr.416, datë 13.5.2015 si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 6 datë 12.6.2019, "Për miratimin e rregullores", "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor" "Për pajisjen me leje të subjektit "BAD" sh.p.k me propozim të Z.A.B.U. Shkumbin-Seman.

Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes, për përdorimin të burimit ujor të lumit të Becit, përrenjve të Oparit, dy burimeve, Çifutit dhe përroit Ara e Pirgut degë e lumit Devoll për prodhim hidroenergjie, nga subjekti "BAD" sh.p.k në Bashkinë Korçë, Qarku Korçë.
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin-Seman për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI I KBUS SEMAN
BAKI BALA